

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPALLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Specialist II, Sektori Juridik & Ankimimet, Drejtoria Juridike (Kategoria IV-a).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Vendimit Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2022”; Urdhër Nr.6667/1, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

**Kërkesat e posaçme për përgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zoterimi i nje gjuhe të huaj përbën avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Specialist II ka për detyrë si më poshtë:**

- Specialisti II i Sektorit Juridik &Ankimimet varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit Juridik&Ankimimet.
- Jep këshilla, opinione dhe ndihmë juridike, me iniciativë apo sipas kërkesës, për të gjitha srtukturat e IMT-së në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit rigoroz të Kushtetutës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Vë në dispozicion të stafit të IMT-së, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që i kërkojen.
- Angazhohet në përpilimin e urdhreve dhe udhëzimeve të brendshme të Kryespektorit.
- Ndjek të gjitha shkallët e shqyrtimit apo të gjykimit me autorizim të Kryeinspektorit të gjithë proceset administrative apo gjyqësore, ku institucioni është palë ndërgjyqëse paditëse ose e paditur dhe në raste ku IMT është person i tretë.

- Koordinon, mbikqyr dhe siguron mbrojtje të interesave të IMT:
  - realizimin e përgatitjeve të prapësimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë
  - kërkesave të ndërmjetme
  - kërkesave ankimore në Gjykatë
- Kontribon në zgjidhjen e kërkesave apo ankesave drejtuar IMT, duke këshilluar strukturat përgjegjëse për trajtimin e tyre në lidhje me çështjet me natyrë ligjore e juridike.
- Sugjeron dhe monitoron përgatitjen e materialeve të duhura informuese për IMT në lidhje me përgatitjen e ankesave ankimore, rekurse, memo, draft vendimeve.

**Dokumentat që aplikanti për Specialist II në Sektorin Juridik & Ankimimet duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 06.07.2022 **ora 16.30**